



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2
Dhjetor 2024

POLITIKAT ARSIMORE DHE PËRMIRËSIMI I MËSIMDHËNIES PËR TË ARDHMEN NË NJË QASJE GLOBALE.

Albana Tahiri*

* *Departmenti i Edukimit dhe Anglishtes, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University*

Përmbledhje

Arsimi si fusha kyçe në edukimin dhe emancipimin e brezit të ri, është elementi themelor i kulturës dhe i shoqërisë së një vendi. Elemente të rëndësishme për realizimin e këtij misioni janë politikat arsimore, kuadri ligjor, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të sistemit arsimor dhe evidentimit të aspekteve shoqërore dhe edukative të këtij procesi.

Shumë vite punë në fushën e mësimdhënies, kanë krijuar mundësinë e njohjes në mënyrë gjithnjë e më të thellë të ndërveprimit midis politikave arsimore dhe mësimdhënies. Nëpërmjet kësaj analize mund të depërtojmë në kompleksitetin e strukturës arsimore, në dinamikën e zhvillimit të saj ku fokusin kryesor e përqendrojmë tek të nxënit, në formësimin e individit dhe më gjerë të shoqërisë, duke e parë këtë proces në kontekstin e ri, në të cilin janë vendosur raportet e politikave arsimore dhe mësuesve qofshin ata me përvojë formale ose joformale në mësimdhënie, shumë të kualifikuar apo pa kualifikime, duke sjellë jo vetëm një fytyrë të re të kurrikulave, por edhe të rolit të politikave arsimore tek mësimdhënësit, në shkollat tona.

Metodologjia e këtij punimi bazohet në literaturën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si në Legjislacionin e arsimit Parauniversitar, *Kurrikulen e Arsimit Parauniversitar* të Republikës së Shqipërisë. *Strategjia Kombëtare e Arsimit-Shqipëri (2021-2026)* mbi vëzhgimet e kërkimet e eksperiencave personale shumëvjeçare në fushën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar.

Ndërthurja e materialit teorik me përvojën praktike sjell disa këndvështrime, lidhur me politikat në arsim në kushtet e reja me të cilat po përballlet jo vetëm sistemi ynë arsimor, por e gjithë shoqëria jonë.

Konkluzion; Studimi konfirmon rëndësinë dhe rolin e politikave arsimore, për realizimin e strategjive kombëtare në arsim, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të sistemit arsimor. Evidentimin e aspekteve shoqërore me moton e përbashkët se të mësuarit në shkollat tona duhet t'u ofrojë nxënësve dhe studentëve një përvojë unike nga vlerat sociale e humane, për të nesërmen e qytetarisë shqiptare në kuadrin evropian dhe më gjerë. Mësimdhënia duhet të pasqyrojë parimet bazë të marrëdhënies të shëndetshme si: ndershmërinë, drejtësinë integritetin, guximin, respektin, përgjegjshmërinë etj.

Fjalë çelës: *politika në arsim, mësimdhënie, proces, edukim, kompetenca, të nxënit etj.*

POLICIES IN EDUCATION, TEACHING WITH COMPETENCIES FOR AN APPROACH TO GLOBAL EDUCATION

Abstract

Education, as a key field in the education and emancipation of the new generation, is the fundamental element of a country's culture and society. Important elements for the realization of this mission are the educational policies, the legal framework, which directly influence the increase in the efficiency of the educational system and the identification of the social and educational aspects of this process.

Many years of work in the field of teaching have created the possibility of knowing in an ever deeper way the interaction between educational policies and teaching. Through this analysis, we can penetrate into the complexity of the educational structure, into the dynamics of its development, where the main focus is on learning, on the shaping of the individual and, more broadly, of society, seeing this process in the new context, in which the reports of educational policies and teachers, whether those with formal or informal experience in teaching, highly qualified or unqualified, have been established, bringing not only a new face to the curricula, but also the role of educational policies to teachers, in our schools.

The methodology of this work is based on the literature of the Ministry of Education and Sports, as in the Pre-University Education Legislation, the Pre-University Education Curriculum of the Republic of Albania. National Education Strategy-Albania (2021-2026) on the observations and research of many years of personal experiences in the field of teaching in pre-university education.

The interweaving of theoretical material with practical experience brings several perspectives, related to education policies in the new conditions that not only our education system is facing, but our entire society.

Conclusion; The study confirms the importance and role of educational policies, for the realization of national strategies in education, which directly affect the increase in the efficiency of the educational system. The identification of social aspects with the common motto that learning in our schools should offer pupils and students a unique experience of social and humane values, for the future of Albanian citizenship in the European framework and beyond. Teaching should reflect the basic principles of healthy relationships such as: honesty, justice, integrity, courage, respect, responsibility, etc.

Keywords; *policy in education, teaching, process, education, competences, learning, etc.*

Hyrje

Politikat arsimore, kuadri ligjor në arsimin parauniversitar.

Sa herë që ulemi për të shkruar, një artikull, apo qoftë edhe një recensë për një libër të botuar, përfshihemi emocionalisht dhe përpiqemi të mos lëmë asgjë pa thënë dhe asnjë fakt pa interpretuar, padyshim shumë vite punë në fushën e mësimdhënies, kanë krijuar mundësinë e njohjes në mënyrë gjithnjë e më të thellë të ndërveprimit midis politikave arsimore dhe mësimdhënies.

Politikat arsimore dhe arsimit i një vendi organizohen dhe drejtohen përmes shtetit, i cili vepron si për çdo fushë tjetër me ligje e rregulla të caktuara. Në dekadat e fundit reformat arsimore elementin më të rëndësishëm kanë lidhjen ngushtë me arsimin progresiv, krahasuar me periudhat kohore të

reformave të tjera arsimore, është se në synimet e saj përfshihen përpjekje të qarta për të ndryshuar pedagogjinë, shoqëruar me ndërtimin e një baze ligjore.

Në bazë tezës sonë qëndron rëndësia që ka rrolli i politikave arsimore për; Realizimin e strategjive kombëtare në arsim, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të sistemit arsimor. Evidencat e aspekteve shoqërore me moton e përbashkët se të mësuarit në shkollat tona duhet t'u ofrojnë nxënësve dhe studentëve një përvojë unike në vlerat sociale e humane, për të nesërmen e qytetarisë shqiptare në kuadrin evropian dhe më gjerë.

Nëpërmjet kësaj analize mund të depërtojmë në kompleksitetin e strukturës arsimore, në dinamikën e zhvillimit të saj ku fokusin kryesor e përqendrojmë tek të nxënësve ku e drejta për arsimim kuptohet si e drejtë për të nxënë.

Në këtë këndvështrim (Tahiri, A. & Hadaj, G.2022) kemi trajtuar rolin e arsimit në formësimin e individit dhe më gjerë të shoqërisë, duke e parë këtë proces në kontekstin e ri, në të cilin janë vendosur raportet e politikave arsimore, kuadrin ligjor, mësimdhënies me kompetenca dhe mësuesve qofshin ata me përvojë formale ose joformale në mësimdhënie, shumë të kualifikuar apo pa kualifikime.¹ Çdo mësues i arsimit parauniversitar në bibliotekën e tij personale ose në dosjen e punës duhet të ketë të arshivuar “Ligjin nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. I azhurnuar me: Ligjin Nr. 56, datë 28.05.2015. Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën E Shqipërisë Urdhër nr.31, datë 28.01.2020. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. “Konventën për të drejtat e fëmijëve”. “Deklaratën universale për të drejtat e njeriut”, por e shumë dokumente të ndryshme që janë në fushën e legjislacionit e më gjerë.(Tahiri. A& Shegani.K 2017)² Nuk mund të pranohet që një mësues i sapo diplomuar të mos ketë asnjë njohuri për legjislacionin në sistemin arsimor parauniversitar, i cili rregullon marrëdhëniet dhe veprimtarinë e shkollës. Mësuesi me profesionalizëm të lartë e me përkushtim në punë, i jep jetë legjislacionit në arsim duke trupëzuar në kreativitetin e tij qasjet dhe ndryshimet e reja. Në këtë kontekst, sjellim risi në interpretimin dhe përvetësimin e ligjeve, akteve nënligjore, rregullores institucionale, e më shumë fokusi drejtohet drejt politikave arsimore.³ Tahiri, A. (2021).

Në librin e e saj ‘Arsimi në vendet jashtë BE-së në Evropën Perëndimore dhe Jugore (Arsimi në mbarë botën) studiuesja Terra Sprague (Universiteti i Bristolit, MB) thekson se një nxitës i rëndësishëm i reformës në arsim ishte dhe ende mbetet harmonizimi i objektivave të politikës kombëtare me aspiratat dhe standardet mbarë-evropiane dhe ndërkombëtare Legjislacioni dhe interpretimi i tij sjellin kuadrin e nevojshëm dhe të domosdoshëm ligjor në përputhje me politikat e reja arsimore të një vendi .⁴ (Sprague,T. 2016).

1 Tahiri, A. & Hadaj, G.2022) The Role of the Native Language Curriculum and School in the Language Development of Children March 2022

DOI:10.54808/IMCIC2022.01.181https://www.researchgate.net/publication/358934336_The_Role_of_the_Native_Language_Curriculum_and_School_in_the_Language_Development_of_Children

2 Tahiri, A.& Shegani.K.2017 “Politikat në arsim dhe fuqia e gjuhës “OMSCA-1, 2017, ISBN 992813295X9789928132956.Tiranë.https://books.google.al/books/about/Politikat_n%C3%AB_arsim_dhe_fuqia_e_gjuh%C3%ABs.html?id=o1EiyQEACAAJ&redir_esc=y

3 Tahiri, A. (2021). Implementing innovations in student-centered teaching. In A. Csiszár-ik-Kocsir & P. Rosenberger (Eds.), Current Studies in Social Sciences 2021(pp. 135–150). ISRES Publishing.<https://www.isres.org/implementing-innovations-in-student-centered-teaching-319-s.html>

4 Sprague, T. 2016 (ed.), Education in Non-EU Countries in Western and Southern Europe, pp. 123-149. London: Bloomsbury Publishing. <https://www.amazon.com/Education-Non-EU-Countries-Western-Southern/dp/1472592492>

Sistemi arsimor shqiptar dhe kompleksiteti i tij padyshim, janë një pasuri e një sërë zhvillimesh dhe aktiviteteve historike, politike dhe sociale, ku edukimi i vlerave aplikohet në çdo aspekt të procesit të arsimit, duke e lidhur ngushtë me dimensionet etike të jetës, që mund të strukturohen dhe monitorohen nëpërmjet metodave dhe mjeteve të duhura edukative.

Kuadri ligjor në Shqipëri ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, e të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin.

Ligji garanton të drejtën për arsimim për të gjithë fëmijët, pavarësisht nevojave të tyre dhe aftësive të veçanta, duke parashikuar arsimim falas dhe të detyrueshëm. Neni 2 i ligjit Nr. 69/2012, “Për arsimin parauniversitar” parashikon nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, përkatësisht: a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor; b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor; c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët; ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë.⁵ (arsimi.gov.al 2018)

*Arsimi parashkollor në Shqipëri përfshin kopshtet dhe klasat parashkollore, për fëmijët 3-6 vjeç, por nuk është i detyrueshëm. Fëmijët mbi moshën 6 vjeçare kanë të drejtën e arsimit bazë i cili përbëhet nga cikli fillor dhe arsimi i mesëm i ulët. Struktura është aktualisht, me arsimin bazë të detyrueshëm; ai zgjat 9 vjet dhe është për nxënës deri në 16 vjeç. Të gjithë ata që nuk kanë përfunduar arsimin bazë dhe janë mbi moshën 16 vjeç mund ta përfundojnë atë në shkollat me kohë të pjesshme*⁶ (MAS-i, 2014a, f. 14). Sot në Evropë e më gjerë, politikat arsimore janë në funksion të të nxënësve konstruktiv, bashkëpunues dhe përdorimit të një modeli të ri vlerësimi, bazuar tek kompetencat, kjo të bën të kthesh sytë tek cilësia e përgatitjes së zhvillimit profesional të mësuesve (si ata fillestar e në vazhdim), duke dashur me këtë të reflektojmë mbi fuqinë e ligjit dhe politikave arsimore si në aspektin teorik e praktik.

Për rrjedhojë, problemi i shkallës mund të përfshihet në kontekstin e debatit aktual rreth reformës, si një nevojë për të ndryshuar thelbin e shkollimit si një mësim gjithëpërfshirës në sfidën për përvetësimin e një përmbajtjeje të lartë akademike.

Akademiku Richard Elmore, njëkohësisht njohësi dhe kritiku për reformat arsimore në Amerikë, thekson faktin *se tema e argumentit, që i përqendron analizat tërësisht në thelbin e shkollimit, nuk është sugjerimi se mësimdhënia dhe mësimnxënia duhet të ndryshohen veças kuptimit të faktorëve që ndikojnë në jetët e fëmijëve; nuk është as sugjerimi se objekti i reformës duhet të zëvendësojë një lloj uniformiteti të praktikës së mësimdhënies me një tjetër.*⁷ (Elmore.R.2011.fq 6,) Ai mendon se shumë reforma arsimore kurrë nuk kanë arritur, e akoma më shumë të kenë ndikuar, në krijimin e modeleve afatgjata të praktikave të mësimdhënies, por janë akoma më të padobishme e të kota, nëse synimi i tyre ka qenë të ndikojnë vetëm në përmirësimin e mësimnxënies të nxënësve. Praktikata mësimore duhet të ndryshojnë nga modeli aktual, më një model më ambicioz e përfshirës, ku të kemi çfarë të ofrojmë në këto praktika mësimdhënie në mënyrë krijuese ndaj kërkesave të tregut të punës.

Nga kjo pikëpamje, reformat shkollore, të fokusuar në ndryshimin e kushteve kryesore që ndikojnë në marrëdhëniet nxënës-mësues-njohuri, mund të kritikohen ose si shumë të ngushtë, ose si shumë të gjerë. Për fat të keq ose të mirë, shkaqet kryesore të dështimit të reformave arsimore kanë sjellë në të njëjtën kohë një kërkesë për performancë ku stimulon njohuri të reja lidhur me kurrikulën, pedagog-

5 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Pligj-parauniversitari-i-azhornuar.pdf>

6 Urdhër 363, datë 16.09.2014 për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar.<https://arsimiparauniversitar.gov.al/MASR/udhezime/>
<https://arsimi.gov.al/>

7 Richard F. Elmore 2011 “Reforma shkollore nga brenda jashtë, politika, praktika dhe performanca” shtypia botuese Universitare U.F.O. Press, prill 2011 fq 6, 16, fq 23

jinë dhe përmirësimin organizativ të shkollës.

Problemi kryesor është si të lidhim atë që dimë rreth praktikave më të mira me atë që ndodh realisht në shkollat tona. Në të vërtetë, nxitës kryesor në fushën e arsimit ka qenë mungesa e lidhjes ndërmjet asaj që përshkruhet në politikën e arsimit dhe asaj që ndodh në shkolla dhe klasa në përgjigje të këtyre politikave. Reforma shkollore duhet të ndodhë “nga brenda jashtë” shprehet profesor Elmore, një pozicion i tillë mund të shprehet më së miri përmes tezës se “problemet e sistemit janë problemet e njëjësive të tij më të vogla”. (Elmore.R.2011.fq fq23)

Me pak argument politikëbërësit në të gjitha nivelet duhet të marrin në konsideratë praktikën e suksesshme të mësuesve në klasa, ose pedagogëve në auditore, një tezë e tillë vepron tek politikëbërësit të cilët kanë shumë për të mësuar nga jeta e shkollës, lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave të mira.

Politikat arsimore dhe roli i tyre në fusha kyçe në procesin e edukimit.

Arsimi si fusha kyçe në edukimin dhe emancipimin e brezit të ri, është elementi themelor i kulturës dhe i shoqërisë së një vendi, duke i paraprirë zhvillimeve në të gjitha fushat e jetës.

Politikat arsimore janë të përcaktuara nga axhenda ideologjike dhe politike e qeverive, të cilat krijojnë strategjitë e mësimin, duke u lidhur shpesh edhe me faktorë të tjerë, ku padyshim vendimet politike duhet të jenë shumë dimensionale dhe se brenda çdo konteksti mësuesit dhe aktorët e tjerë duhet të jenë të përfshirë dhe të komunikojnë me politikëbërësit.

Raporti i Analizës së Politikës Arsimore (APA) siguron një prespektivë të gjerë dhe një analizë të thellë të tri fushave kyçe të politikës: *Zhvillimin dhe reformimin e kurrikulës; Teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) në arsim; dhe Politikën për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, gjithashtu* vë në dukje një numër çështjesh të përbashkëta që janë me rëndësi strategjike për reformën në sektorin e arsimit si përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, komunikimit dhe transparencës përmes arsimit gjithëpërfshirës; Promovimi i institucioneve dhe i infrastrukturës së fortë shkollore; Forcimi i kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin e reformave në arsim.⁸ (UNESCO, Education 2030)

Konteksti i ri, në të cilin janë vendosur raportet e mësuesit dhe nxënësit në kushtet e reja të integritimit, në parim duket se ka sjellë jo vetëm një fytyrë të re të kurrikulave, por edhe të rolit të politikave arsimore tek mësimdhënësit, në shkollat tona. *‘Miratimi i kurrikulës me bazë kompetencat është qartësisht në përputhje me dëshirën për t’i pajisur qytetarët me aftësitë të cilat u nevojiten atyre për të pasur sukses në një Europë multikulturale gjithnjë e më konkurruese. Kjo dëshirë mund të shpjegojë gjithashtu vendimin për të përdorur tekste shkollore të prodhuara për tregun ndërkombëtar nga botues të huaj..’*⁹ (MAS 2015 – 2017)

Një numër çështjesh duhet të jenë me rëndësi strategjike për reformën në sektorin e arsimit për, përmirësimin e strategjive më efikase në edukimin e brezit të ri, bazimi në praktikën shkencërisht më të suksesshme evropiane e më gjerë. si p,sh

Punësimi i të rinjve, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje. Përgjegjësia kryesore për të nxitur punësimin e të rinjve i përket shtetit. Prandaj është e rëndësishme ekzistenca e koherencës, koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare, si në nivel qendror dhe në atë lokal. Insti-

8 ‘Shqipëria Analiza e Politikës Arsimore: Çështje dhe Rekomandime ‘Education 2030, Sector United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization. https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000259245_alb

9 Reporti Vendor, Kreu 2.3.1 Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore SHQIPËRIA MAS 2015 – 2017

tucionet rrjedhimisht kanë nevojë për fuqi punëtore të kualifikuar, partnerë social të angazhuar dhe bashkëpunimin e të rinjve.¹⁰(Rosas.G& Rossignotti,G: 2008)

Parandalimi i korrupsionit nëpërmjet edukimit. Integrimi i edukimit antikorrupsion në arsim nuk do të ishte i suksesshëm, nëse ai nuk do të vendosej në një kontekst konkret e real, historik, social, ekonomik, kulturor e psikologjik. Kjo kërkon që kurrikulat e lëndëve shoqërore, veçanërisht hapësirat që ekzistojnë në kuadrin e kurrikulës në bazë shkolle, të pasurohen me konceptet dhe njohuritë e domosdoshme për edukimin kundër korrupsionit, në të gjitha aspektet e tij¹¹. (PACA 2012)

Edukimi antikorrupsion mund të realizohet nëpërmjet dy formave: Të përfshihet në objektivat e të nxënësve në kurrikulën e detyruar dhe atë me zgjedhje, si në arsimin e detyruar, po ashtu dhe në atë të mesëm. Mund të jetë pjesë e verpimtarisë ekstrakurrikulare, në nivel klase, shkolle, komuniteti shkolle, që përfshin: fushatat qytetare, konferenca, veprimtari rinore etj (BE, KE, 2012)

Arsimi shumëkulturor i referohet çdo forme të edukimit apo të mësimit që përfshin historitë, tekstet, vlerat, besimet dhe perspektivat e njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore. Në përgjithësi, të edukosh shumëllojshmërinë kulturore, do të thotë të zbatosh parimin e barazisë në arsim për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga kultura, dhe të përpiqesh të kapërcesh pengesat për të siguruar mundësi arsimore dhe sukses për nxënësit me prejardhje të ndryshme kulturore.¹² (Tahiri, A. Rama, B. 2024)

Edukimi me një qasje më shumë gjithëpërfshirëse, ku sipas UNICEF¹³ (2015), arsimi gjithëpërfshirës është përgjigje ndaj nevojave të nxënësve dhe jetës së tyre. Arsimi gjithëpërfshirës është mjeti sipas të cilit metodat e mësimdhënies janë me në qendër fëmijën dhe promovojnë mundësi të barabarta, megjithatë, nevojat për përfshirje duhet të integrohen në të gjitha disiplinat dhe të zbatohen në një mënyrë ekzakte.

Përmirësimi i proceseve demokratike në shkollë, përmes parimit se të gjithë janë të barabartë, kanë të drejta të barabarta dhe gëzojnë liritë që u takojnë. Në shkollë ngrihen organet kolegjiale dhe fëmijët e të rinjtë kanë të drejtë të organizohen, të zgjidhen e të zgjedhin. Problemi qëndron në nevojën e vendosjes dhe të zbatimit të kriterëve përmes përcaktimit të raporteve të përfaqësimit.

Padyshim, çështjet e sipër përmendura janë me rëndësi strategjike për reformën në sektorin e arsimit në përmirësimin e strategjive efikase në edukimin e brezit të ri, por pa harruar se çdo shkollë mund të mbështetet në mësuesit e saj energjikë, efektivë, të angazhuar e të interesuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor edukativ, ku për realizimin e këtij misioni padyshim duhet të gjejnë mbështetje tek politikatat arsimore dhe kuadri ligjor i vendit.

10 (Rosas.G& Rossignotti,G: 2008), Udhëzues për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve Guide for the preparation of national action plans on youth employment. Gianni Rosas and Giovanna Rossignotti: International Labour Office Geneva: 1.0. 2008 72 p.

ISBN 978-92-2-120616-3 (Print)

ISBN 978-92-2-120617-0rWeb pafy ISBN 978-92-1-29618-7(CD ROME)

https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@ed_emp/documents/instructionalmaterial/wcms_140786.pdf fq9

11 Edukimi kundër korrupsionit Manual për mësuesit Tiranë, shtator 2012(PROJECT AGAINST CORRUPTION IN ALBANIA (PACA) Hartuar dhe botuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian.

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ec1a3>

12 Tahiri, A. Rama, B. (8-13 March 2024) ‘‘Language, Globalization and Cultural Linguistic Diversity ‘‘ *The 12th Annual Conference of Europe’s Sciences and Arts Leaders and Scholars*

It’s About People 2024 In Service of Sustainability and Dignity The 12 th Annual Conference of Europe’s Sciences and Arts Leaders and Scholar

https://conference.almamater.si/wp-content/uploads/2024/01/C24_Programme.pdf

13 https://www.unicef.org/albania/media/476/file/Raport_studimor-Perballimi_i_sfidave_te_arsimit_gjithperfs hires.pdf

Profili i politikës është një kontribut në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies, ku zbatimi i suksesshëm i reformave do të varej nga qartësimi i kësaj reforme për të gjitha grupet e interesit mësuësve, prindërve, punëdhënësve, etj ku shpesh herë nuk është dhe aq i qartë nga hartuesit e politikave arsimore që do të thotë se praktikatat e suksesshme të implementuara në klasa rrallë ndikojnë në hartimin e politikave, dhe që praktikuesit kanë akses në politikë vetëm pasi ajo është filtruar përmes kurrikulës dhe teksteve shkollore.

Në këtë kontekst reformatori Amerikan Richard Elmore shprehet se për fat të keq, studimi i organizimit dhe politikave në arsim, nuk të mbush me optimizëm. Shpesh të duket sikur je në mitologjinë greke, të sjell ndër mend Sizifin dhe dënimin që iu dha: të ngjiste lart, në kodër, një shkëmb të rëndë, i cili sapo arrinte në majë, i rrëzohej nga duart e çdo gjë riniste përsëri e përsëri nga fillimi. Edhe reforma arsimore është një sipërmarrje e ngjashme: e shohim si rrokulliset nga maja ku e kemi çuar me aq mundim, për të rinisur përsëri nga e para, me gjeneratën tjetër të reformës¹⁴. (Elmore, Richard F. (1986).)

Politikbërësit, në botën e analizave politike, baticën dhe zbatimit e çështjeve politike, përgjithësisht e procedojnë me intervale tre ose pesëvjeçare. Shumë rrallë një çështje e vetme politike tërheq vëmendjen e politikbërësve për një periudhë më të gjatë se ajo e cituar më lart; shumë rrallë politikbërësit angazhohen edhe më tej në çështje për të cilat duhet të rri merren.

Mësimdhënia me kompetenca për një qasje në edukimin global.

Politikat në arsim dhe mësimdhënia, vijnë si një binom domethënës dhe shumëplanësh në çdo kohë. Mësimdhënia me qendër nxënësin, e quajtur mësimdhënie bashkëkohore dhe ndërvepruese kërkon një përgatitje të gjithanshme të mësuesit, pra vihet theksi te roli i mësuesit, jo vetëm si udhëheqës i një ore mësimi, por edhe si përçues vlerash dhe parimesh, përmes metodave dhe risive.

Punën studimore e kemi përqendruar në fushën e arsimit, sepse besojmë që është një mënyrë e mirë për të kontribuar në mirëqenien e fëmijëve tanë e të gjithë shoqërisë, duke lënë gjurmë në orientimin e mëtejshëm të kërkimeve tona. Është gjë e bukur kur punojmë me ndershmeri e gjallëri dhe përqendrohemi në çështjet më të rëndësishme të punës sonë mësimore. Një frymëzim i tillë vazhdon të ushqejë optimizmin në këtë punë, ndonëse jo gjithmonë është i dukshëm në ato që shkruajmë.

Mësimdhënia bashkëkohore, është baza e ndërtimit të një shoqërie globaliste. Mësuesi është modeli dhe idhulli i nxënësit ashtu siç është mjeku për pacientin; kështu, imazhi që mësuesi shpalos përpara nxënësve, autoriteti i tij, aftësitë dhe mënyra se si ai përcjell njohuritë e tij tek ata, shndërrohen në frymëzim ndikimi në jetën e nxënësve. Kështu, të gjitha këto elemente përkthehen në vlera që mësuesi i mbart vetë dhe domosdoshmërisht ua kultivon edhe nxënësve me të cilët punon.¹⁵ (Tahiri, A. (2021).

Të gjithë mund të risjellim në mendje të paktën një mësues që na ka frymëzuar për të lexuar e për të mbushur me dashuri për dijen, ose ndryshe duke ndjekur frymëzimin e heroit tonë në rrugën tonë të lidershit. Gjithmonë i nderojmë e adhurojmë këta mësues. Ashtu sikurse në kujtimet tona përmendim shpesh herë shumë mësues, që nuk japin mësim në mënyrë interesante ose emocionuese por kujdeseshin më shumë për mënyrën e veshjes ose parfumit që përdornin.

Duke u nisur nga këndvështrimi si specialiste arsimit, mendojmë se mësimdhënia efektive lid-

14 Elmore, Richard F. (1986). "Arsimi pasuniversitar në menaxhim publik: duke punuar në qasjet e qeverisë". *Gazeta e Analizës dhe Menaxhimit të Politikave*. 6 (1): 69–83. doi : [10.1002/pam.4050060107](https://doi.org/10.1002/pam.4050060107).

15 Tahiri, A. (2021). Technology in Teaching, as an Empowerment of Innovative Education. The Eurasia Proceedings of Educational and Social Sciences, 20, 70-81. <https://doi.org/10.55549/epess.1038712>

het me karakteristika individuale ku karakteristika të tilla akoma nuk i perceptojmë si normë në politikbërje. Për sa kohë që do të vazhdojmë ta konsiderojmë angazhimin dhe përkushtimin e mësuesve në mësimdhënie si një karakteristikë individuale dhe jo si një normë, e krijuar për të matur profesionalizmin e tij, nuk kemi asnjë arsye të habitemi a të pyesim pse një specialiste e tillë është kaq e rrallë në sistemin tonë arsimor

Mendojmë se dhe mësimdhënia aspak interesante, në formë statike e të mërzitshme, mund të lidhet edhe me paaftësinë tonë për të trajnuar, zgjedhur dhe vlerësuar mësuesit, në përputhje me kapacitetin e tyre për ta zhvilluar mësimin në mënyrë gjithëpërfshirëse, ose me faktin se aspekti organizativ i sistemit tonë arsimor është i tillë që nuk promovon dhe mbështet mësimdhënien e mirë, edhe në të ato pak raste kur është e pranishme.

Shqetësim vjen puna burokratike e mësuesve, harxhimi i kohës për mbushje letrash dhe mos pasja kohë e kërkimit shkencor për të përmirësuar procesin e mësimdhënies e që sjell dobësimin profesional të mësuesve

Ndërveprimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm të sistemit arsimor, si akademikët, politikëbërësit, mësuesit dhe profesionistët relevantë, mundëson ndarjen e pikëpamjeve dhe diskutimin e çështjeve që lindin nga përvojat e ndryshme të cilat janë mjete për të inkurajuar eksperimentimin dhe inovacionin, duke çuar në ndryshimet pozitive të metodave të zhvilluara në nivel lokal, të cilat përmirësojnë përparimin arsimor.

'Konsultimi me ekspertët dhe praktikuesit lokalë do t'iu mundësojë politikëbërësve të vlerësojnë dhe t'iu përgjigjen çështjeve që mund të lindin kur ekspertët e huaj të promovojnë një praktikë të caktuar të mësimdhënies që mund të jetë në kundërshtim me praktikën lokale social -kulturore. «dija e specializuar globale» ka nevojë të përshtatet «për t'iu përshtatur rrethanave lokale. (Rajagopalan K,2005 f. 119)

Konkluzione

Procesi i hartimit të politikave duhet të jetë gjithëpërfshirës. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të komunikojnë përvojat e tyre tek politikëbërësit për t'u siguruar se ajo që mësohet në shkollë, është relevante në kontekste të ndryshme në të cilat ata punojnë.

Është e nevojshme të sigurohemi që politikëbërja është një proces konsultativ që merr parasysh rolin e mësuesit si pikë kontakti.

Mungesa e komunikimit midis politikëbërësve dhe zbatuesve (dhe aktorëve të tjerë), do të thotë se praktikën e suksesshme të implementuara në klasë rrallë ndikojnë në hartimin e politikave, dhe që praktikuesit kanë akses në politikë vetëm pasi ajo është filtruar përmes kurrikulës dhe teksteve shkollore.

Një konkluzion i tillë përforcon argumentin kryesor që shtrohet në këtë artikull, përpjekjet për të ndikuar në modelet kryesorë të praktikave mësimore në shkollat tona . Mësuesi është çështje krenarie, dinjiteti, respekti dhe vlere për shoqërinë. Një mënyrë për ta ndrequr këtë mangësi do të ishte që t'u jepej fuqi mësuesve të përcaktonin kurrrikula me bazë kompetencash specifike për shkollën. Plane pune, që synojnë të pasurojnë veprimtaritë e bazuara në tekstet duke shtuar kontekstin social kulturor përkatës

Prioritet duhet të jetë zhvillimi social e emocional me më pak stres, më shumë bashkëpunim, mjedis sa më i qetë, mësuesit dhe nxënësit të njohin dhe respektojnë njëri-tjetrin, pasi një mësues punon për

një periudhë shumëvjeçare me të njëjtët nxënës. Mësuesit ndihmojnë nxënësit, i frymëzojnë për të arritur qëllimet e tyre për jetën.

Gjëja më urgjente, sot në Shqipëri, është t'u mësohen fëmijëve, prindërve, mësuesve ekzistues, "Si të lexojnë situata të ndryshme" dhe "si të sillen në ato situata". Përparësi, duhet të jetë mësimi i rregullave të edukatës qytetare në mënyrë që secili nga ne « të bëj gjëra të vogla me vlera të mëdha- Shën Tereza»

Dhe si përfundim, duke ju referuar specialistes së arsimit Fatmiroshe Xhemalaj refleksion 2024, në një debat televiziv citoj fjalët e saj "A jemi gati t'i dëgjojmë të rinjtë"? Asnjë diplomë mësuesie nuk merr vlerë, pa provuar, se si punohet me fëmijët e të rinjtë në shkolla.

Sistemi arsimor, nuk duhet të mburret, kryesisht, me arritjet shkencore, të fëmijës dhe të rinjve, por me edukatën qytetare, që i jep përmes shembujve. Shembujt, pozitiv, apo negativ i japin sjelljet dhe qëndrimet e institucioneve, duke filluar nga Parlamenti e deri në institucionet vendore, ku qytetaria i sheh si model.

Fëmijët e të rinjtë, duhen mësuar si të jetojnë shëndetshëm, ata duhet të dinë të sillen në një sistem hierarkie vlerash qytetare në mënyrë që të ndjekim rrugën e të parëve tanë "për me u ba shqyptarët - Gjergj Fishta"

Referenca

- I. Tahiri, A. & Hadaj, G. (2022) The Role of the Native Language Curriculum and School in the Language Development of Children March 2022
DOI: [10.54808/IMCIC2022.01.181](https://doi.org/10.54808/IMCIC2022.01.181) https://www.researchgate.net/publication/358934336_The_Role_of_the_Native_Language_Curriculum_and_School_in_the_Language_Development_of_Children
- II. Tahiri, A. & Shegani, K. (2017) "Politikat në arsim dhe fuqia e gjuhës "OMSCA-1, 2017, ISBN 992813295X9789928132956. Tiranë. https://books.google.al/books/about/Politikat_n%C3%AB_arsim_dhe_fuqia_e_gjuh%C3%ABs.html?id=o1EiyQEACAAJ&redir_esc=y
- III. Tahiri, A. (2021). Implementing innovations in student-centered teaching. In A. Csizsárik-Kocsir & P. Rosenberger (Eds.), Current Studies in Social Sciences 2021 (pp. 135–150). ISRES Publishing. <https://www.isres.org/implementing-innovations-in-student-centered-teaching-319-s.html>
- IV. Sprague, T. (2016) (ed.), Education in Non-EU Countries in Western and Southern Europe, pp. 123-149. London: Bloomsbury Publishing. <https://www.amazon.com/Education-Non-EU-Countries-Western-Southern/dp/1472592492>
- V. <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Pligj-parauniversitari-i-azhornuar.pdf>
- VI. Urdhër 363, datë 16.09.2014 për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar. <https://arsimiparauniversitar.gov.al/MASR/udhezime/>
<https://arsimi.gov.al/>
- VII. Richard F. Elmore (2011) "Reforma shkollore nga brenda jashtë, politika, praktika dhe performanca" shtëpia botuese Universitare U.F.O. Press, prill 2011 fq 6, fq 16, fq 23
- VIII. "Shqipëria Analiza e Politikës Arsimore: Çështje dhe Rekomandime" Education 2030, Sec-

tor United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization. https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000259245_alb

- IX. Reporti Vendor, Kreu 2.3.1 Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore SHQIPËRIA MAS 2015 – 2017. [1 \(arsimi.gov.al\)](http://arsimi.gov.al) Analizë e politikës arsimore Çështje dhe rekomandime UNESCO Sekcioni i Politikës Arsimore Prill 2017 [Albania: education policy review; issues and recommendations \(alb\) - UNESCO Digital Library](#)
- X. Udhëzues për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@ed_emp/documents/instructionalmaterial/wcms_140786.pdf
- XI. Guide for the preparation of national action plans on youth employment. Gianni Rosas and Giovanna Rossignotti: International Labour Office Geneva: 1.0. 2008 72 p. ISBN 978-92-2-120616-3 (Print) ISBN 978-92-2-120617-0 (Web) pafy ISBN 978-92-1-29618-7 (CD ROM) https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@ed_emp/documents/instructionalmaterial/wcms_140786.pdf fq9
- XII. Edukimi kundër korrupsionit Manual për mësuesit Tiranë, shtator 2012 (PROJECT AGAINST CORRUPTION IN ALBANIA (PACA) Hartuar dhe botuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ec1a3>
- XIII. Tahiri, A. Rama, B. (8-13 March 2024) ‘‘Language, Globalization and Cultural Linguistic Diversity ‘‘ *The 12th Annual Conference of Europe’s Sciences and Arts Leaders and Scholars. It’s About People 2024 In Service of Sustainability and Dignity The 12 th Annual Conference of Europe’s Sciences and Arts Leaders and Scholar* https://conference.almamater.si/wp-content/uploads/2024/01/C24_Programme.pdf
- XIV. https://www.unicef.org/albania/media/476/file/Raport_studimorPerballimi_i_sfidave_te_arsimit_gjithperfshires.pdf
- XV. *Elmore, Richard F. (1986). “Arsimi pasuniversitar në menaxhim publik: duke punuar në qasjet e qeverisë”. *Gazeta e Analizës dhe Menaxhimit të Politikave*. 6 (1): 69–83. doi : 10.1002/pam.4050060107.*
- XVI. Tahiri, A. (2021). Technology in Teaching, as an Empowerment of Innovative Education. The Eurasia Proceedings of Educational and Social Sciences, 20, 70-81. <https://doi.org/10.55549/epess.1038712>
- XVII. Rajagopalan K., The language issue in Brasil: When local knowledge clashes with expert knowledge, 2005 f. 119
- XVIII. *Elmore, Richard F.; Watson, Sara; Pfeiffer, David (1992). “Një rast për përfshirjen e çështjeve të politikave të aftësisë së kufizuar në kurrikulat e politikave publike”. *Gazeta e Analizës dhe Menaxhimit të Politikave (Shënime të Kurrikulës dhe Rasteve)*. 11 (1): 167–173. doi : 10.2307/3325146. JSTOR 3325146.*
- XIX. Raport studimor, 2016, “Përballimi i sidave të arsimit gjithpërshirës në Shqipëri”, ACCES, ISOP, UT, Instituti i Opinionit Publik në Shqipëri, UNICEF.
- XX. Hadaj, G. ., & Tahiri, A. . (2023). Morphological Homonymy in the Verbal Structure of the

- XXI. Hadaj, G., & Tahiri, A. (2023). Themes of grammatical forms in the nominative system. *international conference on contemporary academic research*, 1, 226–231. <https://doi.org/10.59287/iccar.784>
- XXII. Tahiri, A. (2021). Implementing innovations in student-centered teaching. In A. Csiszár-ik-Kocsir & P. Rosenberger (Eds.), *Current Studies in Social Sciences 2021* (pp. 135–150). ISRES Publishing.
- XXIII. <https://www.isres.org/implementing-innovations-in-student-centered-teaching-319-s.html>
- XXIV. Hadaj, G., & Tahiri, A. (2023). Emojis, widely used in modern communication. *The International Journal of Learner Diversity and Identities*, 30(2), 403–408. https://scholar.google.com/citations?view_op=view_citation&hl=en&user=moEWyz0AAAAJ&citation_for_view=moEWyz0AAAAJ:Se3iqnhoufwC
- XXV. Tahiri, A., & Hadaj, G. (2022). *Innovation, education and Tips and Tricks transfer, through language components him extracurricular projects, in preschool education, for maintaining public health and nutrition*. *Journal of Hygienic Engineering & Design*, 41. Retrieved From <https://keypublishing.org/jhed/wp-content/uploads/2024/07/07.-Full-paper-Albana-Tahiri.pdf>